




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.		Nr Prot.	
Dep.	Z-D/DPK	Br Prot	01-3111/14
Dep.		Prot No	
Nr. I faq		Data	
Broj stranica	02	Datum	05-09-2014
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.09.2014, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2453-14 për z.Istref Elshani–Këshilltar Komunal në Komunën e Drenasit, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-2453-14, për Zyrtarin e lartë, z.Istref Elshani – Këshilltar Komunal në Komunën e Drenasit dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z.Istref Elshani fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-012648/14), pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Elshani është deklaruar do të nis procedurën e shuarjes së biznesit për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Rekomanimi i Agjencisë ka qenë që zyrtari i lartë të heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar të biznesit që do të mjaftonte për të shmangur konfliktin e interesit. Por, përcaktimi i zyrtarit për shuarje të biznesit ka qenë vendim i tij individual dhe vullnetar.

Ndërkohë, meqense z.Elshani i ka kaluar afatin e parë i caktuara nga Agjencia për të realizuar këto ndryshime, me datën 29.08.2014 Agjencia kundër Korrupsionit i ka bërë edhe shkresën e dytë paralajmëruese (Z.D./DPK-01-3074/14).

Menjëherë pas kësaj, z.Elshani, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellur një shkresë zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-3050-14) në të cilën shihet se biznesi privat, D.P.Z."Doni", është shuar në mënyrë vullnetare.

Me këtë z.Elshani, ka shmangur situatën e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik - Këshilltar Komunal në Komunën e Drenasit.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

